



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Nr. 1460/4 Prot.

Tiranë, më 18.12.2025

URDHËR

Nr. 166, datë 18.12.2025

**“PËR PUBLIKIMIN E LISTËS SË DOKUMENTEVE QË OFROHEN NË
FORMATIN E TË DHËNAVE TË HAPURA”**

Në mbështetje të nenit 7, të Ligjit Nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, Urdhrit Nr. 121, datë 02.10.2025 “Për caktimin e personit të kontaktit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për të dhënat e hapura” si dhe Urdhrit nr. 132, datë 05.11.2025 “Për ngritjen e grupit të punës të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për të dhënat e hapura”,

U R D H Ë R O J:

1. Publikimin në faqen zyrtare të institucionit, në Seksionin “Të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit”, të listës së dokumenteve të mëposhtme që ofrohen në formatin e të dhënave të hapura për qëllime ripërdorimi.
 - Kalendari i trajnimeve.
 - Raportet vjetore dhe statistikore të ASPA-s.
 - Raportet e vlerësimit të impaktit të trajnimit.
 - Plani Strategjik.
 - Bashkëpunimet.
 - Vendimet e Këshillit Drejtues të ASPA.
 - Rekomandimet/ Raportet e auditit.
 - Buxheti i miratuar vjetor.
 - Raportet e Monitorimit.
 - Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike.
 - Regjistri i Realizimit të Prokurimeve Publike.
 - Lista e kontratave të lidhura (Kontratat e Prokurimit të detajuara).
2. Kjo listë të përditësohet periodikisht me dokumente, që prodhohen nga strukturat përbërëse të institucionit, për qëllime ripërdorimi.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Trajnimit dhe Komunikimit si dhe Drejtoria e Zhvillimit dhe Vlerësimit të Cilësisë .
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I KOMANDUAR

Emona Boçe

